



## HYRJE NË BIZNESIN NDËRKOMBËTAR

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
<b>Titulli i lëndës:</b>	Hyrje në Biznesin Ndërkombëtar
<b>Programi:</b>	Agrobiznes
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Zgjedhore (Z)
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti 3 / Semestri 5
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 + 2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6 ECTS
<b>Koha / lokacioni:</b>	Do të shpallet
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Asoc. Dr. Kushtrim Braha
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	kushtrim.braha@uni-prizren.com; +383 49 531 537
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë shqyrton një gamë të gjerë të problemeve të biznesit ndërkombëtar. Fillimisht, lënda trajton çështjet që kanë të bëjnë me kuptimin e disa nocioneve që ndërlidhen me biznesin ndërkombëtar. Në pjesën e dytë, trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me rregullat dhe kushtet nën të cilat mund të zhvillohet biznesi ndërkombëtar, të cilat i përcaktojnë institucionet ekonomike ndërkombëtare dhe komponentët e mjedisit biznesor ndërkombëtar. Në pjesën e tretë, trajtohen llojet e ndryshme të operacioneve biznesore si dhe veprimet e tjera të nevojshme për realizimin e tyre. Në fund, lënda trajton çështjet financiare lidhur me tregtinë ndërkombëtare, siç janë financimi i tregtisë ndërkombëtare, kushtet e pagesës, instrumentet e pagesës dhe garancitë.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë ka për qëllim që t'u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike lidhur me kushtet nën të cilat zhvillohen aktivitetet biznesore ndërkombëtare si dhe mënyrat dhe procedurat e zhvillimit të aktiviteteve biznesore ndërkombëtare.</p>
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Kuptojnë drejtë përmbajtjet e nocioneve të ndryshme nga fusha e biznesit ndërkombëtar.</li><li>▪ Kuptojnë kushtet në të cilat zhvillohen aktivitetet biznesore ndërkombëtare.</li><li>▪ Njohin llojet e ndryshme të operacioneve biznesore ndërkombëtare.</li><li>▪ Aftësohen në realizimin e operacioneve të ndryshme biznesore ndërkombëtare.</li><li>▪ Njohin dhe kuptojnë rreziqet të cilave u ekspozohen gjatë zbatimit të operacioneve biznesore dhe të zbatojnë masa adekuate mbrojtëse.</li><li>▪ Zhvillojnë kompetencat në drejtimin e operacioneve biznesore ndërkombëtare.</li></ul>



Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	4	4
Kontaktet me mësimdhënësin (konsultimet)	2	3	6
Ushtrime në teren	3	3	9
Kollokviume, seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	6	7	42
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	3	3
Përgaditja përfundimtare për provim	1	1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	15	30
Projektet, prezentimet etj.	8	3	24
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime, diskutime, konsultime, projekte kursi, detyra shtëpie, kollokviume, provimi përfundimtar.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vijueshmëria e rregullt dhe aktive: 10%,</li> <li>▪ Provimi i ndërmjetëm (kollokviumi): 20%,</li> <li>▪ Projekti i kursit: 10%,</li> <li>▪ Provimi final: 60%.</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	Kukaj, H. (2017) Biznesi Ndërkombëtar. Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren. Kristo, I. (2007) Biznesi Ndërkombëtar. PEGI, Tiranë.		
<b>Literatura shtesë:</b>	Hill, C.W. dhe Hult, T.G. (2017) Biznesi Ndërkombëtar. McGraw-Hill Education, (botimi në gjuhën shqipe u realizua nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për zhvillim- AADF, 2019) Hill, C.W. (2007). International Business. McGraw-Hill, New York. Daniels D.J., Radebaugh H.L. dhe Sullivan, D.P. (2004) International Business – Environments and Operations. Pearson, Prentice Hall, New Jersey.		



Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Biznesin ndërkombëtar	Shpërndarja e temave të projekteve seminarike.
<i>Java e dytë:</i>	Globalizmi	Kuize dhe raste studimore nga tema e javës së parë të ligjëratave.
<i>Java e tretë:</i>	Teoritë dhe Politikat e tregtisë së jashtme dhe të investimeve të huaja të drejtpërdrejta	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së dytë të ligjëratave.
<i>Java e katërt:</i>	Institucionet ekonomike ndërkombëtare në funksion të biznesit ndërkombëtar	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së tretë të ligjëratave.
<i>Java e pestë:</i>	Integrimet ekonomike rajonale	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së katërt të ligjëratave.
<i>Java e gjashtë:</i>	Mjedisi i biznesit ndërkombëtar	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së pestë të ligjëratave.
<i>Java e shtatë:</i>	Tregjet e specializuara ndërkombëtare	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së gjashtë të ligjëratave.
<i>Java e tetë:</i>	Provimi i ndërmjetëm (Kolokviumi I)	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së shtatë të ligjëratave.
<i>Java e nëntë:</i>	Operacionet Biznesore ndërkombëtare	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së tetë të ligjëratave.
<i>Java e dhjetë:</i>	Operacionet Biznesore ndërkombëtare - vazhdim	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së nëntë të ligjëratave.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dokumentet e nevojshme në tregtinë ndërkombëtare</li> <li>▪ Procedurat doganore</li> </ul>	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së dhjetë të ligjëratave.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Procedurat doganore - vazhdim	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së njëmbëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Formalizmi i Operacioneve Tregtare Ndërkombëtare	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së dymbëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Financat e tregtisë ndërkombëtare <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Financimi i tregtisë ndërkombëtare</li> <li>▪ Kushtet pagesave, instrumentet e pagesave dhe garancitë</li> </ul>	Kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së trembëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kolokviumi II	Prezentimi i projekteve semestrale.
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe Kodin e etikës.</li> <li>▪ Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm.</li> <li>▪ Studenti posedojë dhe paraqesë ID kartën në provime e ndërmjeme dhe provime përfundimtare,</li> <li>▪ Gjatë hartimit të projekteve të kursit, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimet e dhëna nga mësimitdhënësi.</li> <li>▪ Gjatë orës së provimit është i ndaluar përdorimi i celularëve.</li> </ul>		